



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 1864 Prot.

Tiranë, më 19.07.2023

URDHËR
Nr. 5, datë 19.07.2023

PËR
NGRITJEN E KOMISIONEVE TË KONKURSEVE TË PRANIMIT TË KANDIDATËVE SI
DHE SHPALLJEN E DATAVE PËR KONKURIMIN PRANË FSHL DHE FVFR
PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024

Mbështetur në Urdhërin e Përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar Nr.10, datë 10.07.2023 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2023-2024”, në Udhëzimin Nr.12, datë 30.06.2023 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, si dhe në Rregulloret e Brendshme të Fakulteteve “Për zhvillimin e konkursit të pranimit për vitin akademik 2023-2024, Rektori

URDHËRON:

- Të ngrihet Komisioni Qëndror i UST-së si vijon:
 - Prof.Dr. Agron Kasa Kryetar
 - Prof.Asc.Dr. Fisnik Brovina Anëtar
 - Prof.Asc.Dr. Ferdinand Mara Anëtar
 - Prof.Dr. Dhimitraq Prifti Anëtar (Vëzhgues pranë FSHL)
 - Prof.Asc.Dr. Arben Kaçurri Anëtar (vëzhgues pranë FVFR)
- Pranë UST-së të ngrihet Komisioni i Verifikimit, i cili është përgjegjës për procedurat e verifikimit të kandidatëve konkures, si vijon:
 - Majlinda Rëmbeci Kryetare
 - Pranvera Lozi Anëtare
 - Mimoza Reçi Anëtare
- Brenda datës 16.08.2023, ora 08.⁰⁰, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, të përcjellë në Rektorat për miratim Komisionin e Vlerësimit të kandidatëve, si dhe Komisionin e Ankimimit të përbërë nga 3-5 vetë. Në përbërje të këtij të fundit duhet të jetë një jurist.
- Brenda datës 20.08.2023, ora 08.⁰⁰, Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, të përcjellë në Rektorat për miratim Komisionin e Vlerësimit të kandidatëve, si dhe Komisionin e Ankimimit të përbërë nga 3-5 vetë. Në përbërje të këtij të fundit duhet të jetë një jurist.

5. Konkursi i pranimit për FSHL-në do të zhvillohet nga **16.08.2023 – 19.08.2023** dhe për FVFR-në nga **data 20.08.2023 – 22.08.2023**, data të cilat afishohen në faqen zyrtare të UST-së.
6. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (Sektori i Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes), të komunikojnë me subjektet përkatëse për të siguruar mosndërprerjen e energjisë elektrike nga data 16.08.2023 deri më datë 22.08.2023. Për një mbarëvajtje sa më të mirë dhe cilësore, të sigurohet gjithashtu brënda të njëjtave data edhe shërbimi i përforcuar nga Komisionari i Policisë për mbikqyrjen e konkursit të pranimit.
7. Fakultetet të marrin masat për sigurimin e bazës materiale të domosdoshme për zhvillimin e konkursit të pranimit. Gjatë ditëve të konkursit duhet të jetë i pranishëm një nga mjekët e secilit fakultet bashkë me materialet e nevojshme për dhënien e ndihmës së shpejtë.
8. Për zbatimin e këtij Urdhëri, ngarkohen Dekanatet e Fakulteteve, Administratori i UST-së, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (Sektori i Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes).
9. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.Dr. Agron KASA

